



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 nën paragrafi d) nën 40.2 nën c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nën 30 të Ligjit Nr.03/L-448 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, të nën 16 të Ligjit nr.06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, nën 40 nën pikën 3 të Statutit të Komunës së Klinës, me rekomandimet e KPF të dt.10.09.2018, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VIII-të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më 21.09.2018, mori këtë:

V E N D I M

Për transfer/rialokim të mjeteve për

I. Miratohet vendimi për transfer/rialokim të mjeteve.

II. Ri-alokim i mjeteve për Paga dhe meditare , fondi burimor 10

Në kuadër të programit Arsim dhe Shkencë (920), nga nen-programi Administrata (92090), kodi funksional (0980) transferohet shuma 7,000.00 € në nen-programet :

Arsimi parashkollor dhe çerdhet (92550), kodi funksional (0911), shuma 1,000.00 € dhe
Arsimi fillor (93510), kodi funksional (0912) , shuma 3,000.00 €
Arsimi i mesëm (94710) ,kodi funksional (0922), shuma 3,000.00 €

Transfer i mjeteve për Paga dhe meditare , fondi burimor 10

Nga programi Zyra e kryetarit (160), nen-programi (16018) kodi funksional (0111) , transferohet shuma 5,000.00 €

Nga programi Zyra komunale për komunitete (195) , nen-programi Zyra komunale për komunitete dhe kthim (19590), kodi funksional (1090) , transferohet shuma 4,500.00 € dhe

Nga programi Administrata dhe personeli (163), nen-programi Administrata (16318), kodi funksional (0133), transferohet shuma 4,000.00 € .

Nga Programi Inspekcioni (166),nenprogrami Inspekcioni (16635) kodi funksional (0411),transferohet shuma 4,000,00 € .

Në programin Arsim e shkencë (920) , nen-programi Arsimi i mesem (94710) , kodi funksional (0922) shuma 16,000.00 €

Në programin **Sherbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca** (180), nen-programi **Infrastruktura rrugore** (18018), kodi funksional (0451) shuma 1,000.00 € dhe

Në programin **Planifikimi urban dhe mjedisi** (660), nen-programi **Planifikimi urban dhe inspeksioni** (66395), kodi funksional (0620) shuma 500.00 €

Ri-alokim i mjeteve për projekte kapitale, fondi burimor 10

Në kuadër të programit **Planifikimi urban dhe mjedisi** (660), nen-programi **Planifikimi urban dhe inspeksioni** (66395), kodi funksional (0620) nga projekti **Kanalizimi në Gjurgjevik të madh**, kodi - 43811, shuma 15,840.48 € dhe nga projekti **Kanalizimi në Dush të Sferkës**, kodi - 44956, shuma 27,331.89 € të ri - alokohen në projektin **Bashkfinancim me donator**, kodi - 43803, shuma 43,172.38 €.

Transfer në kuadër të kategorisë ekonomike shpenzime kapitale fondi burimor 10

Nga programi **Administrata dhe personeli** (163), nen-programi **Administrata** (16318), kodi funksional (0133) nga projekti **Rregullimi i ofiqarisë në Gllarevë**, kodi - 46922, transferohet shuma 2,281.37 €.

Nga Programi **Sherbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca** (180), nen-programi **Infrastruktura rrugore** (18018), kodi funksional (0451) nga Projekti **Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimeve**, kodi-9064 transferohet shuma 10,000.00 €.

Nga Programi **Inspeksioni** (166), nenprogrami **Inspeksioni** (16635) kodi funksional (0411) nga Projekti **Shenjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve**, kodi 45027 transferohet shuma 5,478.00 €.

Në programin **Planifikimi urban dhe mjedisi** (660), nen-programi **Planifikimi urban dhe inspeksioni** (66395), kodi funksional (0620) në projektin **Bashkfinancim me donator**, kodi - 43803, shuma 17,759.37 €.

Arsyetim :

Kategoria ekonomike e Pagave

Rialokimet dhe transferet të kategorisë e pagave kërkohen me qëllim të harmonizimit të tepricave dhe mungesave brenda programeve dhe nënprogrameve komunale në bazë të rrjedhave të ekzekutimit të buxhetit për periudhën janar-gusht 2018 dhe trendit të shpenzimeve nëpër këto nënprograme deri në fund të vitit 2018.

Kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale

Pas përfundimit të procedurave të prokurimit dhe nënshkrimit të kontratave me operatorët ekonomik, në disa projekte vlera e kontraktuar ka rezultuar të jetë me e vogël se vlera e planifikuar dhe e buxhetuar për ato projekte prandaj është kërkuar të bëhen rialokimet/transferet

e propzuara me lartë. Në vijim po pasqyrojmë te dhënat lidhur me tepricat e mjeteve qe kërkohet te rialokohen/transferohen si ndryshim i vlerës se buxhetuar dhe te kontraktuar në projekte te caktuara.

	Vlera e buxhetuar	Vlera e Kontratës	Teprica-mbetja
Kanalizimi në Gjyrgjevik te madh	60,000.00	44,159.52	15,840.48 €
Kanalizimi në Dush te Sferkës	70,000.00	42,668.11	27,331.89 €
Rregullimi i ofiqarisë në Gllarevë	15,000.00	12,718.63	2,281.37 €
Mirëmbajtja e rrjetit te kanalizimeve	30,000.00	20,000.00	10,000.00 €
Shenjezimi horizontal dhe vertikal i rrugëve	15,000.00	9,522.00	5,478,00 €

III. Vendimi miratohet më kërkesën e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe implementimi behet po nga kjo Drejtori.

IV. Vendimi është I plotëfuqishem me miratim në Kuvendin e Komunës dhe 15 ditë pas prtokolimit në MAPL dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqën e Komunës.

V. Me këtë Vendim njoftohen: MAPL, MF Kryetari i Komunës, Drejtoria FEZH, Shërbimi për Punë të Kuvendit dhe Arkivi i Komunës së Klinës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 60-6294 2018
Klinë, më 26.09 2018

